



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 270 prot.

Tiranë më 5.2.2018

**VENDIM**

Nr. 06, datë 5.2.2018

**PËR**

**RRËZIMIN E ANKESËS**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1501 Prot., datë 16.11.2017, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Me kërkesën e datës 03.10.2017 ankuesi ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion duke kërkuar sa më poshtë:

- 1. Numrin total të subjekteve që kanë paraqitur formularin e vetë-deklarimit profesional, brenda afatit ligjor, sipas nenit 41, pika 1 e ligjit për vettingun, të ndara edhe sipas kategorive prokurorë dhe ndihmës ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme. A ka patur subjekte që nuk kanë respektuar këto afate? Nëse po, sa është numri i këtyre subjekteve dhe a janë paraqitur prej tyre argumenta/arsye që justifikojnë mosplotësimin e afatit ligjor?*
- 2. Si është organizuar struktura e Prokurorisë së Përgjithshme që ka bërë vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në kompetencë të saj? A janë miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm udhëzime për procedurat e detajuara që duhet të ndiqen për procesin e vlerësimit profesional? Nëse po, kërkojmë të njihemi me përmbajtjen e këtyre akteve.*

3. *A ka përfunduar brenda afateve ligjore, procedura e vlerësimit të aftësive profesionale nga ana e strukturës përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për të gjitha subjektet që e kanë paraqitur formularin e vetë-deklarimit profesional? Nëse jo, cili është numri total i subjekteve të rivlerësimit për të cilat vlerësimi i aftësive profesionale nuk ka përfunduar brenda afatit? Të ç'natyre kanë qenë pengesat apo vështirësitë që kanë ndikuar në mosrespektimin e këtyre afateve?*
4. *A ka qenë rregullimi ligjor i parashikuar në ligjin e vettingut, mjaftueshëm i qartë dhe i plotë për ushtrimin e kompetencave nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të vettingut?*
5. *Bazuar në nenin 43, pika 2 të ligjit për vettingun, a janë përgatitur nga struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme, raportet e hollësishme dhe të arsyetuara të vlerësimit profesional të subjekteve? A paraqiten në këto raporte konkluzione për përmbushjen ose jo të nivelit të kërkuar të aftësive profesionale nga këto subjekte? Nëse po, si paraqitet në vija të përgjithshme gjendja e aftësive profesionale të subjekteve të cilat janë vlerësuar deri më tani nga kjo strukturë?*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1501 Prot., datë 16.11.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 303 datë 04.12.2017, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik informuan grupin e inspektimit lidhur me arsyet e vonesës në kthimin e përgjigjes për Komitetin Shqiptar të Helsinkit duke sqaruar se: *Në momentin e depozitimit të kërkesës për informacion nga kërkuesi, organet vendimmarrëse të rivlerësimit nuk ishin krijuar ende dhe Prokuroria e Përgjithshme, si organ me funksion ndihmës në këtë proces, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, ngriti grupin e punës për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit vetëm pas fillimit të punës së organeve kompetente siç është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Apelit (KA). Gjithashtu, me shkresën nr. 2599/1 Prot., datë 05.12.2017 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke informuar kërkuenin lidhur me objektin e kërkesës për informacion.*

Nga administrimi i provave në aktet shkresore, Zyra e Komisionerit konstaton se informacioni i kërkuar në pikën 1, lidhur me - *“Numrin total të subjekteve që kanë paraqitur formularin e vetë-deklarimit profesional, brenda afatit ligjor, sipas nenit 41, pika 1 e ligjit për vettingun, të ndara edhe sipas kategorive prokurorë dhe ndihmës ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme. A ka patur subjekte që nuk kanë respektuar këto afate? Nëse po, sa është numri i këtyre subjekteve dhe a janë paraqitur prej tyre argumenta/arsye që justifikojnë mosplotësimin e afatit ligjor?”*, - i është vënë në dispozicion kërkuetit nga Autoriteti Publik i cili në përgjigjen e tij ka sqaruar kërkuenin lidhur me shifrat dhe të dhënat e kërkuara sipas pikës përkatëse në objektin e kërkesës.

Sa i përket informacionit të kërkuar në pikën e dytë, në të cilën kërkohet: *“Si është organizuar struktura e Prokurorisë së Përgjithshme që ka bërë vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në kompetencë të saj? A janë miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm udhëzime për procedurat e detajuara që duhet të ndiqen për procesin e vlerësimit profesional? Nëse po, kërkojmë të njihemi me përmbajtjen e këtyre akteve”*. - Autoriteti Publik ka vënë në dispozicion të kërkuarit dokumentacionin mbështetës dhe më konkretisht:

- (i) Urdhër nr. 208, datë 17.10.2017 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar”;
- (ii) Urdhër nr. 208/1, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime të urdhrin nr. 208, datë 17.10.2017”;
- (iii) Urdhër nr. 208/2, datë 09.11.2017 “Për nxjerrjen e ngarkesës së Prokurorëve për procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016”;
- (iv) Formatin standard të miratuar për Raportin e Vlerësimit të Aftësisë Profesionale të Subjektit të Rivlerësimit;
- (v) Rregulla për zhvillimin e shortit për përzgjedhjen e 5 dosjeve.

Lidhur me pikën e tretë të kërkesës ku kërkohet informacion nëse *“Ka përfunduar brenda afateve ligjore, procedura e vlerësimit të aftësive profesionale nga ana e strukturës përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për të gjitha subjektet që e kanë paraqitur formularin e vetë-deklarimit profesional? Nëse jo, cili është numri total i subjekteve të rivlerësimit për të cilat vlerësimi i aftësive profesionale nuk ka përfunduar brenda afatit?”*, - në kthim përgjigjen e dërguar nga Autoriteti Publik, ankuesi është sqaruar lidhur me ecurinë e procesit të vlerësimit profesional sipas metodologjisë së përcaktuar dhe zbatuar nga Autoriteti Publik në përputhje me Rregullat e miratuara për këtë qëllim (të cilat i janë vënë në dispozicion dhe ankuesit), dhe për të cilën është rënë dakord dhe me KPK-në.

Sa i përket pikës 5 dhe më konkretisht: - *Bazuar në nenin 43, pika 2 të ligjit për vettingun, a janë përgatitur nga struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme, raportet e hollësishme dhe të arsyetuara të vlerësimit profesional të subjekteve? A paraqiten në këto raporte konkluzione për përmbushjen ose jo të nivelit të kërkuar të aftësive profesionale nga këto subjekte?* – Komisioneri vlerëson se kësaj pyetje Autoriteti Publik i ka dhënë përgjigje në pikën 2 dhe 3 të përgjigjes së tij duke i vënë gjithashtu në dispozicion këtij të fundit dhe formatin standard të raportit.

Për sa i përket fjalisë së fundit në pikën e tretë të kërkesës dhe më konkretisht - *“Të ç natyre kanë qenë pengesat apo vështirësitë që kanë ndikuar në mosrespektimin e këtyre afateve?”*, pikës së katërt - *“A ka qenë rregullimi ligjor i pavarshikuar në ligjin e vettingut, mjaftueshëm i qartë dhe i plotë për ushtrimin e kompetencave nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të vettingut?”* dhe fjalisë së fundit të pikës së pestë *“Si paraqitet në vija të përgjithshme gjendja e aftësive profesionale të subjekteve të cilat janë vlerësuar deri më tani nga kjo strukturë?”*, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar nuk i referohet një të dhëne të rregjistruar (dokumenti), por konsiston në dhënien e një vlerësimi në formën e opinionit nga ana e Autoritetit Publik. Gjatë procesit të hetimit administrativ nuk u

konstatua ekzistenca e nje informacioni të tillë. Në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Për sa më sipër, Komisioneri e konsideron kërkesën për informacion të përmbushur lidhur me informacionet që ky Autoritet Publik disponon.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit kundër Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme”, Komisioneri vlerëson se ajo është e pabazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankimit nr. 1501 Prot., datë 16.11.2017 të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, kundër Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme”.
2. Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 05. 2 .2018.

### KOMISIONERI

**Besnik Dervishi**

